

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Mybera Latifi, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.S, nga fshati B, komuna e V, për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar i armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.488/15 të dt.24.11.2015, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.30.03.2017, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari dhe i akuzuari, me dt.03.04.2017 mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.S, i biri i S dhe F, e gjinisë S, i lindur me dt.*data e lindjes*, nga fshati G, komuna e V, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse

Me dt.13.06.2015, rreth orës 01.30 min., në lokalin ‘S’ në fshatin B, ka përdorë armën- në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në atë mënyrë që derisa ishte duke qëndruar në lokal, ka nxjerrë nga brezi armën dhe ka shtënë njëherë përpjetë në drejtim të tavanit, me ç’rast policia ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe pas kontrollimit të njëjti është gjetur revolva e tipit ‘Zastava’, me nr.serik ET-991779, me dy fishekë të kal.6.35mm në karikatorë, dhe një thikë flutur, të cilat më pastaj janë konfiskuar nga policia.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së

II.

Me datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin e parë, i pandehuri B.S, në vendin ku kanë qenë të pranishëm një numër i madh i njerëzve, ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e tyre, në atë mënyrë që derisa ishte duke qëndruar në lokalin e lartcekur ka shtënë një herë përpjetë në tavan me revolen e lartcekur dhe pas goditjes predha është kthyer dhe ka rënë në dyshtemen e lokalit.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së

III.

Nga data e pacaktuar e deri me datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, ka poseduar në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, revolen e tipit ‘Zastava’, me nr.serik ET-991779, me dy fishek, të kalibrit 6.35mm, dhe një thikë flutur, të cilat më pas i janë konfiskuar nga policia.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar i armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 41, 45, 73, 74,75,76 dhe 375 par.1 dhe 3 dhe 365 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 359, 365, 367, 368, 450 dhe 453 të KPRK, e:

GJYKON

-për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dhe

-për veprën penale nën pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, dhe

Në pajtim me nenin 80 par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së, i

SHQIPTON

DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit i konfiskohet revolja e tipit ‘Zastava’, me nr.serik ET-991779, mjet ky me të cilën është kryer vepra penale, dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së

REFUZOHET AKUZA

Për veprën penale në pikën III të dispozitivit të aktakuzës Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar i armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP/I.nr.488/15 të dt.24.11.2015, kundër të akuzuarit B.S, për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, Shkaktimi i rrezikut të

përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar i armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.30.03.2017, dhe pas leximit të aktakuzës, prokurori i shtetit ka heq dorë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar i armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, derisa për dy veprat tjera penale, në pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës, i akuzuari e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e këtyre veprave penale me të cilën është akuzuar.

Prokurori i shtetit nuk ka pas vërejtje në deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprave penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për kryerjen e veprave penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkëlqje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e këtyre veprave penale, dhe të njëjtat edhe i ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit B.S, manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar i armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, që me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, që ta merr parasysh pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e zhvillimit të kësaj procedure penale dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ashtu që këto rrethana ti vlerësoj si rrethana lehtësuese.

I akuzuari B.S në fund deklaroi se shpreh keqardhje dhe pendim të thellë për këto veprime të tij në të kaluarën, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërit veprime të tilla të ngjashme, andaj e ka lut gjykatën që mundësisht t'ia shqiptoj një sanksion sa më të butë të mundshëm penal, duke pas për bazë edhe rrethanat tjera lehtësuese në këtë çështje penale.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të llojit dhe lartësisë të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, sjelljen dhe qëndrimin e tij shumë korrekt në gjykatë, pendimi i thellë i tij për këtë vepër penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris asnjëherë këto veprime, si dhe gjendjen e vështirë ekonomike, i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes, jeton në kushte të rënda ekonomike, derisa si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë, e në mungesë të rrethana rënduese gjykata të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në

përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 50 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlíkueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e armës është marrë konform nenit 375 par.3 të KPRK-së.

Ndërkaq sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, është refuzuar akuza, pasi që prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës, ka hjek dorë nga ndjekja penale për këtë veprë penale, dhe gjykata ka marrë vendim në pajtim me nenin 363 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 363 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.666/15, dt.03.04.2017

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.